



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002776/8

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë.*

MINISTRISË SË DREJTËSISË
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
Tiranë

Për dijeni : **INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE**
Tiranë

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi A. P.. Ankuesi shkruan se ndaj djalit të tij, të ndjerit R. P., me vendimin nr. 380, datë 31.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është vendosur masa mjekësore "Mjekim i detyruar spitalor në një spital psikiatrik". Pas vendosjes së kësaj mase mjekësore, në datën 23.02.2020 djali i tij është dërguar në I EVP Krujë. Ndërkohë gjatë kësaj kohe ka qënë në gjykim kërkesa e bërë prej tij për revokimin e masës mjekësore.

Në datën 21.08.2020, nga administrata e I EVP Krujë ankuesi është njoftuar në telefon se djali i tij R. P. ishte shoqëruar në QSUT pasi kishte probleme shëndetësore. Sipas tij, djali ishte i diangostikuar me "Prapambejtje mendore dhe Epilepsi e gjeneralizuar". Më pas ai është informuar se djali kishte vdekur dhe se trupi i tij ndodhej në morgun e Tiranës për t'u ekzaminuar.

Pas ndodhjes së kësaj ngjarjeje ai ka hasur një problem lidhur me çregjistrimin e tij nga Zyra e Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Topojë, pasi në dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse në "Skedën e vdekjes" nuk pasqyrohen ora dhe shkaku i vdekjes së tij.

Gjithashtu ankuesi shkruan se nuk ka asnjë informacion lidhur me rrethanat dhe shkakun e vdekjes së djalit të tij, nëse është nisur ndonjë hetim penal nga organet kompetente lidhur me këtë ngjarje të rëndë dhe nëse po në cilën fazë ndodhet ai.

Nëpërmjet kësaj ankese ai i kërkon institucionit të Avokatit të Popullit të hetojë rastin e vdekjes së djalit të tij R. P. dhe ta informojë atë lidhur me rrethanat e ndodhjes së kësaj ngjarjeje, cili ka qënë shkaku i vdekjes së tij, ora në të cilën ka ndodhur, si dhe dokumentacioni që provon ato.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e këtij rasti, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, në nenin 19, gërma “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, si dhe në paragrafin e fundit të këtij neni ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, me shkresën nr. K2/A31-4 prot., datë 18.09.2020 drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë i kërkuam që në kuadër të hetimit administrativ të nisur nga institucioni ynë lidhur me këtë ankesë të na dërgonte një informacion lidhur me:

1. A ka përfunduar akti i ekzaminimit mjeko-ligjor i të ndjerit R. P.?
2. Nëse po, cili është shkaku dhe ora e vdekjes së tij?
3. Cili është organi kompetent për lëshimin e “Skedës së vdekjes” dhe pasqyrimin e orës dhe të shkakut të saj në rastet kur në IEVP-të vdes një i dënuar/paraburgosur apo person ndaj të cilit është vendosur masa mjekësore e mjekimit të detyruar?
4. Cilat janë arsyet që në “Skedën e vdekjes” së të ndjerit R. P. nuk janë pasqyruar ora dhe shkaku i vdekjes së tij?
5. Bashkë me informacionin i kërkuam të na dërgonte edhe një kopje të njësuar me origjinalin e aktit të ekzaminimit mjeko-ligjor të të ndjerit R. P..

Ndonëse afati ligjor për dërgimin e informacionit dhe të aktit të ekzaminimit mjeko-ligjor të të ndjerit R. P. kaloi, ato nuk na u dërguan. Për këtë arsye me shkresën nr. K2/A31-7 prot., datë 20.10.2020 drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë i rikërkuam dërgimin e informacionit dhe dokumentit të cituara më sipër. Bazuar në nenin 19, paragrafin e fundit të këtij neni ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, i kërkuam dërgimin e tyre brenda 5 ditëve nga data e mbërritjes së kërkesës tonë. Por edhe pas dërgimit të kërkesës dytë përsëri ky institut nuk na dërgoi informacionin dhe aktin e ekzaminimit mjekoligjor të kërkuara nga ana jonë.

Sjellim në vëmendje se moskthimi i përgjigjeve të kërkuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të një organi të administratës publike me institucionin tonë.

Ky qëndrim i mbajtur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesit. Ndërkohë kjo sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik. Ju kujtojmë se një qëndrim i tillë mosbashkëpunimi nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me institucionin tonë është i përsëritur edhe më parë,

respektivisht në rastin e ankesës së shtetasës E. Sh., për të cilin ju kemi vënë në dijeni me shkresën nr. K2/E39-12 prot., datë 18.02.2020.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*,

KËRKOJMË:

Fillimin e procedurës administrative (ecurisë disiplinore) dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë që nuk kanë kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë fotokopje të shkresave të cituara më sipër respektivisht me nr. K2/A31-4 prot., datë 18.09.2020, nr. K2/A31-7 prot., datë 20.10.2020 dhe nr. K2/E39-12 prot., datë 18.02.2020.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi